



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 384 Akti

Nr. 544 Vendimi

Tiranë, më 30.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 28.6.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati i 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elsa Ulliri**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Elsa Ulliri është subjekt i rivlerësimit, për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Elsa Ulliri, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 23.12.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 13.01.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Trupi gjykues, me vendimin e datës 16.6.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
7. Në datën 16.6.2022, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr.

¹E-mail, datë 13.1.2020, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

²E-mail, datë 16.6.2020, ora 14:26, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit”.

84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 24.6.2022; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 24.6.2020, subjekti paraqiti me anë të postës elektronike³ dhe pranë Komisionit pretendimet e saj me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 24.6.2022, vendosi ta ftojë për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore, lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 28.6.2022, ora 13:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

10. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 28.6.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

12. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

13. Znj. Elsa Ulliri, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca dëgjimore e datës 28.6.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 30.6.2022, për shpalljen e vendimit.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 28.6.2022, subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³E-mail, datë 24.6.2022, ora 16:28 “Mbrojtja”.

⁴E-mail, datë 27.6.2022, ora 08:05 “Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

19. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Elsa Ulliri, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

22. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2013 – 2016 dhe në datën 30.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për burimin financiar të pasurive të përfituara me trashëgimi ligjore*;

⁵Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

(iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, për vitet 2013 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesit.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaramet e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Shtëpi banimi 3 kate, truall me sip. 240 m², ndërtesë me sip. 96 m² dhe arë me sip. 7730,4 m², në *-Krujë**

1.1. Në deklaramet *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron shtëpi banimi 3 kate, që ndodhet në pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë + truall me sipërfaqe totale 7730,4 m², nga e cila 240 m² truall dhe 96 m² ndërtesë, me vendndodhje në ***-Krujë, në bashkëpronësinë e subjektit dhe të familjareve: S., B., A. dhe D. U., ku secili zotëron 1/5 pjesë. Këtë pasuri e kanë trashëguar nga babai, i cili më 13.12.1995 ka ndërruar jetë dhe me vendimin nr. ***, datë 29.1.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë së babait, duke njohur si trashëgimtarë të tij, shtetasit S., B., A., D. dhe Elsa Ulliri, në pjesë të barabarta nga 1/5 secili. Shtëpia e banimit është ndërtuar nga babai. Pjesa takuese: 20 %.

Kjo pasuri nuk është përfituar nëpërmjet shitjes ose blerjes dhe, si rrjedhojë, nuk mund të vendoset një vlerë konkrete me shifra dhe fjalë. Në deklarimin fillestar, subjekti ka deklaruar një shifër duke pasuar parasysh shpenzimet që janë kryer për ndërtimin e shtëpisë dhe vlerën e tregut për këtë pronë, por nuk ka një vlerësim të bërë nga ekspertë vlerësues.

1.2. Burimi i krijimit: përfituar me anë të trashëgimisë nga babai. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶.

1.3. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në para fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi 3 kate, me truall 300 m², ndërtesa 120 m², arë 9243 m², në vlerën 70.000.000 lekë, trashëguar nga babai. Pjesa takuese: 20 %. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi se në datën 4.8.2014, ZVRPP-ja Krujë ka vepruar mbi pasurinë nr. ***, e cila, tashmë, ka këto të dhëna: pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë + truall me sip. 7730,4 m² nga kjo 240 m² truall dhe 96 m² ndërtesë në emër të shtetasve S., B., A., D. dhe Elsa Ulliri.

1.4. Në seksionin “të dhënat konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti deklaroi se pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë + truall me sipërfaqe totale 7730.4 m², nga e cila 240 m² truall dhe 96 m² ndërtesë në momentin e deklarimit fillestar ishte pjesë e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe 9.663 m², konkretisht: truall 300 m², ndërtesa 120 m², arë 9.243 m², në bashkëpronësinë e subjektit dhe të familjarëve. Në datën 4.8.2014, ZVRPP-ja Krujë ka vepruar mbi pasurinë me nr. ***, në bazë të vendimit nr. ***, datë 4.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe urdhrit nr. ***, datë 15.7.2014, të Zyrës së Përbarimit Krujë “Për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme”. Pasuria është përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe trashëguar nga babai A. U.. Për sa i përket shtëpisë së banimit, sipas vendimit nr. ***, datë 4.11.1993, të Këshillit të Komunës *** është miratuar sheshi i ndërtimit të shtëpisë së banimit të qytetarit A. H. U., sipas planimetrisë përkatëse me sipërfaqe 150 m². Me anë të vendimit nr. ***, datë 29.7.2008, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, të KRRT-së, komuna ***, është miratuar sheshi i ndërtimit dhe destinacioni i tij me objekt “shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 kate, ***”, ndërsa me anë të vendimit nr. ***, datë 16.9.2008, të KRRT-së është miratuar leje ndërtimi për shtetasen S. U., për objektin “shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 kate, ***”. Në ndërtimin e shtëpisë së banimit janë përdorur të ardhurat e nxjerra nga shoqëria “A. U.” sh.p.k. (ish-shoqëria “***”).

1.5. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP-ja Krujë⁷ ka informuar se në emër të subjektit dhe familjarëve (S., B., A. dhe D. U.) është e regjistruar

⁶Vërtetim noterial nr. *** rep., datë 25.1.2017, për dokumentet: akti i marrjes së tokës në pronësi me nr.*** akti, datë 10.5.1993, fshati ***, në emër të A. U., gjithsej 17.755 m²; vërtetim datë 25.10.1993, i kryetarit të komunës ***; vendim nr. ***, datë 4.11.1993, nga këshilli i komunës ***; kërkesë për leje ndërtimi datë 10.4.1994, në emër të A. U., në zyrën e urbanistikës në komunën ***; vendim nr. ***, datë 29.1.1996, i Gjykatës së Rrethit Krujë për çelje trashëgimie ligjore, pas ndërrimit të jetës së shtetasit A. U.; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 30.4.2008, nga ZVRPP-ja Krujë; harta treguese, kartela e pasurisë së paluajtshme, në emër të shtetasve S., B., A., D. dhe E. U. në pjesë të barabarta nga 1/5 secili; vërtetim nr. *** prot., datë 30.6.2008, nga ZVRPP-ja Krujë; vendim nr. ***, datë 29.7.2008, i KRRT-së në emër të shtetasve S. U. me objekt: shtëpi banimi në rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 K, në ***. me sip. sheshi 300 m² me sip. ndërtimi 180 m²; leje ndërtimi nr. ***, datë 16.9.2008, e KRRT-së në emër të S. U. me objekt shtëpi banimi në rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 K, në ***, me afat kohor deri më 21.3.2009, bashkëlidhur planimetria e kateve; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, i ZVRPP-së Krujë; vendim nr. ***, datë 4.10.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; urdhër ekzekutimi nr. ***, datë 29.2.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; urdhër me nr. ***, datë 15.7.2014, i zyrës së përbarimit Krujë; vërtetim nr. *** prot., datë 24.3.2015, i ZVRPP-së Krujë.

⁷Dosje e ILDKPKI-së: shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2017; shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2017; shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2019. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2020, Komisioni ka kërkuar informacion pranë ASHK-së lidhur me pasuritë e regjistruara në emër të subjektit dhe prindërve të tij. Rezulton se Zyra Vendore Krujë nuk ka kthyer përgjigje lidhur me sa më sipër, në këto kushte, Komisioni në datën 21.1.2022 ka kryer një aplikim *on line* në sistemin multifunksional të ASHK-së, për të administruar dokumentacionin e kërkuar. Duke qenë se përsëri nuk është kthyer përgjigje, Komisioni iu drejtua sërish ASHK-së me anë të shkresës nr. *** prot., datë 5.5.2022, duke kërkuar informacion në lidhje me pasuritë e

pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***⁸, z. k.***, e llojit arë + truall, me sip. totale 7730,4 m², nga e cila 240 m² truall dhe 96 m² ndërtesë. Sipas kartelës së pasurisë kjo pronë fillimisht ka qenë e regjistruar në emër të shtetasit A. U.. Bashkëlidhur dokumentacionit është vënë në dispozicion vendimi i trashëgimisë nr. ***, datë 27.1.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 10.5.1993, në emër të shtetasit A. U.. Gjithashtu, ZVRPP-ja Krujë, me anë të postës elektronike në datën 24.1.2019, konfirmon se pasuria arë + truall, me sip. 9.663 m², nga kjo 300 m² truall dhe 120 m² ndërtesë në emër të bashkëpronarëve U., ka kaluar në pasurinë me nr. *** vol. ***, f. ***, arë + truall me sip. 7730,4 m², nga kjo 240 m² truall dhe 96 m² ndërtesë në emër të bashkëpronarëve U. dhe në pasurinë nr. *** vol. ***, f. ***, në emër të shtetasit M. M. L. kaluar me vendim të përmbarimit.

1.6. Për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë, rezulton e provuar se është përfituar me trashëgimi, referuar vendimit nr. ***, datë 29.1.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për çelje trashëgimie ligjore, pas ndërrimit të jetës së shtetasit A. U., ku është përcaktuar se trashëgimtarë të radhës së parë janë bashkëshortja dhe 4 fëmijët, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga 1/5 pjesë secili.

Lidhur me ndryshimet që ka pësuar pasuria e deklaruar nga subjekti

1.7. Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja Krujë⁹, rezulton se babai i ndjerë i subjektit A. U., me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. *** akti, datë 10.5.1993, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ka përfituar gjithsej pronën prej 17755 m² të përbërë nga: (i) pasuria nr. ***, sip. 6.900 m², nga të cilat 6700 m² arë dhe 200 m² truall; (ii) pasuria nr. ***, arë me sip. 10855 m², në fshatin ***.

1.8. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 24.1.2017, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, lëshuar nga ZVRPP-ja Krujë, rezulton se: (i) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 6900 m² (nga të cilat 6700 m² arë dhe 200 m² truall); (ii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, arë + truall, me sip. totale 13963 m² (nga e cila 300 m² truall, 120 m² ndërtesë).

1.9. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰, për të qartësuar situatën e kësaj prone të deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, i kërkoi subjektit shpjegime se çfarë përfshihet në sipërfaqen 13.963 m², referuar vërtetimit të paraqitur, ndërkohë që sipas AMTP-së rezulton të jetë përfituar arë me sipërfaqe vetëm 10.855 m². Në përgjigje të pyetësorit¹¹, subjekti paraqiti në cilësinë e provës përgjigjen e ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë¹², ku rezulton se pasuritë kanë pësuar ndryshime pas azhurnimit (matjeve në terren).

1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga subjekti dhe nga hetimi i Komisionit, rezultoi se pasuria nr. ***, e deklaruar në deklaratën *Vetting*, ka rrjedhur nga ndryshimet e pësuar të analizuara në vijim: (i) pasuria nr. *** ka kaluar në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë me sip. 6700 m² (përfituar me AMTP); (ii) pasuria nr. ***, me sip. 10855 m², pas verifikimeve në terren merr nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë+truall+ndërtesë, me sip. 11240

regjistruara në emër të subjektit dhe familjarëve të tij. Informacioni i kërkuar, u administrua nga ASHK-ja Krujë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2022.

⁸Vijon nga vol. ***, f. ***.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2022.

¹⁰E-mail, datë 29.4.2022, ora 13:06 dhe e-mail, datë 4.5.2022, ora 11:33.

¹¹E-mail, datë 11.5.2022, ora 19:31.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 10.5.2022.

m² (nga e cila 300 m² truall e 120 m² ndërtesë) (përfitur me AMTP); (iii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 2723, e llojit arë është përfitur me kontratën e shitblerjes, datë 13.12.2001 (trajtuar në pikën 3 të vendimit); (iv) pasuria nr. ***, me sip. 13.963 m², ka ardhur nga bashkimi i ish-pasurive nr. *** dhe nr. ***, e cila është ndarë në dy pasuri të veçanta; (v) pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale prej 4.300 m², e cila ka kaluar në favor të BKT-së (pra, është në pronësi të BKT-së)¹³; (vi) pasuria me nr.***¹⁴, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale prej 9.663 m², e cila mbeti në bashkëpronësinë e subjektit dhe të familjarëve; (vii) më tej, përsëri kanë ndodhur ndryshime dhe pasuria nr. ***, është ndarë si vijon: (1) Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z.k. ***, arë + truall me sip. 1.932,6 m² (nga e cila 60 m² truall dhe 24 m² ndërtesë), në emër të M. L. me vendim gjykate (*trajtuar në pikën të relacionit*); (2) Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, Arë + truall, me sip. totale 7.730,4 m² (nga e cila 240 m², truall dhe 96 m² ndërtesë), në bashkëpronësi të S., B., A., D. dhe E. U..

1.11. Në konkluzion të analizimit të ndryshimeve mbi këtë pasuri të deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit për pasurinë arë + truall, me sip. totale 7730,4 m² (nga e cila 240 m², truall dhe 96 m² ndërtesë) e përfitur me trashëgimi ligjore.

Lidhur me kohën e ndërtimit të banesës 3-katëshe

1.12. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, në seksionin “të dhënat konfidenciale”, subjekti ka deklaruar se për sa i përket shtëpisë së banimit, sipas vendimit nr. ***, datë 4.11.1993, të këshillit të komunës ***, është miratuar sheshi i ndërtimit të shtëpisë së banimit të qytetarit A. H. U., sipas planimetrisë përkatëse me sip. 150 m². Me vendimin nr. ***, datë 29.7.2008, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, të KRRT-së, komuna ***, është miratuar sheshi i ndërtimit dhe destinacioni i tij, me objekt “shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 kate, ***”. Ndërsa me vendimin nr. ***, datë 16.9.2008, të KRRT-së është miratuar leje ndërtimi për shtetasen S. U., për objektin “shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 kate, ***”. Në ndërtimin e shtëpisë së banimit janë përdorur të ardhurat e nxjerra nga shoqëria “A. U.” sh.p.k. (ish-shoqëria “***”).

1.13. Subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 25.10.1993, të kryetarit të komunës ***, ku vërtetohet se sheshi i ndërtimit të shtëpisë së banimit të shtetasit A. U., ndodhet në pronësi të tij dhe është përfitur në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”. Sheshi i ndërtimi ndodhet në afërsi të shtëpisë ekzistuese, në vendin e matur për truall. Sheshi i ndërtimit të shtëpisë është planifikuar të ndërtohet në një truall inproduktiv (tokë gurishtore). Këshilli i komunës ***, me vendimin nr. ***, datë 4.11.1993, ka miratuar sheshin e ndërtimit të shtëpisë së shtetasit A. U., bazuar në planimetrinë përkatëse me sipërfaqe 150 m² dhe t’i propozojë Këshillit të Rregullimit

¹³Komisioni vëren se referuar kontratës së kredisë nr.***, datë 26.3.2008, rezulton se shoqëria “A. U.” sh.p.k., ka kërkuar lëvrime të shumës 12.500.000 lekë, e cila do të përdorej për të shlyer detyrimet që klienti i ka bankës nga kredia e marrë në datën 30.6.2005, me kontratën nr. ***, kredi e cila nuk është shlyer plotësisht, e siguruar me pronat e hipotekuara sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 30.6.2005. Për shkak se nuk u respektuan afatet e shlyerjes së kredisë, pasuria me nr.***, ka kaluar në pronësi të BKT-së. Ky fakt rezulton nga certifikata për vërtetim pronësie e lëshuar në datën 24.12.2010, nga ZVRPP-ja Krujë. Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkuar të deklarojë në emër të kujt është pjesa e ndërtesës me sipërfaqe 1617 m² që figuron në vërtetimin e pronësisë lëshuar në datën 28.2.2002 dhe në kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 26.3.2008.

¹⁴Vërtetuar me anë të certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 30.4.2008.

të Territorit të Rrethit Krujë dhënien e lejes së ndërtimit. Në datën 10.4.1994, shtetasi A. U. ka paraqitur kërkesë për leje ndërtimi në zyrën e urbanistikës, komuna ***.

1.14. Më tej, me vendimin nr. ***, datë 29.7.2008, KKRT-ja ka miratuar destinacionin e sheshit të ndërtimit, në emër të nënës së subjektit S. U., me objekt “shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati 3 kate”, në *** me sip. sheshi 300 m², me sip. ndërtimi 180 m². Më tej, KKRT-ja ka lëshuar lejen e ndërtimit nr. ***, datë 16.9.2008, në emër të shtetases S. U., me objekt shtëpi banimi rikonstruksion + shtesë + ngritje kati - 3 kate, në ***-Krujë, me afat kohor deri më 21.3.2009.

1.15. Subjektit, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁵, iu kërkuan shpjegime shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, lidhur me sipërfaqen e kësaj shtese, periudhën kur kanë filluar dhe përfunduar punimet për ndërtimin e kësaj shtese (leje ndërtimi, leje shfrytëzimi, akt kolaudimi, situacione etj.), dokumentacionin e regjistrimit të saj në regjistrat hipotekorë, me qëllim shmangien e çdo dyshimi mbi kohën e kryerjes së kësaj shtese, si dhe të vendosen në dispozicion koordinatat në *google maps* të kësaj prone dhe të paraqiten foto nga jashtë të saj.

1.16. Në përgjigje¹⁶, subjekti deklaroi se shtëpia, në të cilën banon dhe ka banuar gjatë gjithë jetës, ka përfunduar së ndërtuari nga babai A. U., që në vitin 1995. Fakt i deklaruar që në deklaratën fillestare, si dhe në deklaratën *Vetting*. Shtëpia përbëhet nga 3 kate banimi dhe e tillë ka qenë që në vitin 1995. Nga viti 1995 e në vijim mbi këtë shtëpi banimi nuk ka ndodhur asnjë ndryshim, pra, asnjë shtesë e asnjë ngritje kati të saj. Leja, me nr. ***, datë 29.7.2008, e KRRT-së, është marrë nga nëna e subjektit për rikonstruksionin e banesës ekzistuese dhe jo për shtesa apo ngritje kati, pavarësisht se në këtë leje është përcaktuar edhe e drejta për të bërë shtesa. Duke qenë se leja nuk është marrë me qëllim bërjen e ndonjë shtese apo ngritjen e ndonjë kati apo të katit të tretë, siç përcakton ajo, provohet pasi shtëpia ekzistuese ishte 3-katëshe dhe nuk ka sens logjik dhe juridik që të jepet leje për shtimin e një kati që tashmë ekzistonte në kohën e dhënies së lejes.

1.17. Në vijim, subjekti deklaroi se fakti që banesa ka qenë 3-katëshe, që në kohën e ndërtimit të saj në vitin 1995 dhe se në vitin 2008 nuk është bërë asnjë shtesë apo ngritje kati, del edhe nga *ortofotot* e vitit 2003 dhe 2007 (periudhë para lejes së KRRT), të paraqitura në cilësinë e provës. Gjithashtu, u paraqitën fotografitë aktuale të banesës dhe *ortofoto* të vitit 2009 dhe 2015, nga të cilat rezulton se banesa është e njëjta me ndërtesën e vitit 2003 dhe 2007, sipas *ortofoto-ve*, që përkon me periudhën para dhënies së lejes së KRRT-së. Pra, dukshëm nuk ka asnjë ndryshim, shtesë anësore apo ngritje kati të kësaj banese dhe, si rrjedhojë, subjekti nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me ndonjë shtesë të mundshme. Koordinatat në *google maps* janë 41.4379102, 19.7488760. Në cilësinë e provës subjekti paraqiti fotografi të banesës nga jashtë, *ortofoto* të viteve 2003, 2007, 2009 dhe 2015.

1.18. Referuar *ortofoto-ve* të viteve 2003 dhe 2007, Komisioni vëren se shtëpia e banimit nuk ka pësuar ndryshime krahasuar me *ortofotot* e viteve 2009 dhe 2015.

1.19. Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se referuar ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin kohën e ndërtimit të shtesës mbi këtë

¹⁵E-mail, datë 29.4.2022, ora 13:06 dhe e-mail, datë 4.5.2022, ora 11:33.

¹⁶E-mail, datë 11.5.2022, ora 19:31.

pasuri, si dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, lidhur me periudhën kohore të ndërtimit të banesës në vitin 1995.

Për të njëjtin hetim më të thelluar e shterues, edhe pse banesa e deklaruar nga subjekti është ndërtuar në vitin 1995, Komisioni analizoi të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e saj.

1.20. Sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, për ndërtimin e shtëpisë së banimit janë përdorur të ardhurat nga shoqëria “A.U.” sh.p.k. (ish-shoqëria “***”).

1.21. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datë 30.9.2014, subjekti është pyetur lidhur me vlerën e deklaruar në DIPP-në para fillimit të detyrës vitit 2003, prej 70.00.000 lekësh. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se sipas deklarimeve të familjarëve, për ndërtimin e kësaj prone janë shpenzuar 70.000.000 lekë, shumë e cila është krijuar nga biznesi i familjes dhe një pjesë e kësaj toke është përfituar nga ligji nr. 7501.

1.22. Sa më sipër, Komisioni analizoi aktivitetin dhe të ardhurat e shoqërisë “A. U.” sh.p.k. Referuar dokumentacionit të administruar nga QKB-ja¹⁷, rezulton se shoqëria “A. U.” sh.p.k. është regjistruar me vendimin nr. ***, datë 23.3.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT *** dhe ushtron aktivitetin në fushën e mobilierisë (prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të mobilieve, elementeve të drurit, import – eksport etj.). Kjo shoqëri është themeluar nga babai i subjektit dhe, më pas, me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin A. U., subjekti dhe familjarët kanë trashëguar kuotat në pjesë të barabarta, nga 1/5 pjesë secili¹⁸.

1.23. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRT-ja Durrës¹⁹, rezulton se subjekti “A. U.” sh.p.k., për periudhën 29.5.2007 – 28.9.2012, figuron me status aktiv. Nga data 28.9.2012 – 20.6.2017, figuron me status pasiv. Nga data 20.6.2017 – 8.5.2018, figuron me status pasiv dhe nga data 9.5.2018 figuron me status aktiv. Më tej, DRT-ja Durrës²⁰, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të administruar pasqyrat financiare të periudhës 1994 – 2016, përcolli pasqyrat për periudhën²¹ 1995– 2010 dhe informoi se për vitet 2011-2012 nuk rezulton që tatimpaguesi të ketë dorëzuar pasqyra financiare. Ndërsa për periudhën 2013 – 2016, duke qenë se ky tatimpagues ka qenë me status pasiv, nuk ka pasur detyrim ligjor për të dorëzuar pasqyra financiare, bën me dije DRT-ja Durrës.

1.24. Nga analizimi i pasqyrave financiare, konstatohet se fitimi ushtrimor është mbartur viti pas viti dhe se nuk është shpërndarë dividend. Rezultoi e provuar se shoqëria “A. U.” sh.p.k.

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 5.2.2020.

¹⁸Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën nr.***, datë 25.9.2014, sipas së cilës ka dhuruar të gjitha kuotat që zotëronte në kapitalin themeltar të shoqërisë “A. U.” sh.p.k. (*trajtuar në vijim të relacionit*). Më tej, me vendimin e asamblesë së ortakëve, datë 12.5.2017, është vendosur dhurimi i kuotave nga ortakët B., A. dhe D. U. në favor të mamasë së subjektit S. U., e cila ka qenë administratore dhe ortakë zotëruese e 100 % të kuotave. Asambleja me anë të vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë/S. U., ka vendosur pushimin e përkohshëm të aktivitetit nga data 20.6.2017 – pa afat. Në datën 21.6.2017, statusi i subjektit është bërë “i pezulluar”. Referuar ekstraktit të shoqërisë rezulton se me anë të vendimit të ortakut të vetëm nr. ***, datë 2.5.2018, është vendosur shitja e 100 % të kuotave dhe është larguar administratorja S. U.. Është shtuar ortaku D. U. (motra e subjektit), e cila është administratore dhe zotëron 100 % të kuotave. Në datën 8.5.2018 statusi i shoqërisë është bërë aktiv, sipas vendimit të datës 4.5.2018, të asamblesë së ortakut të vetëm.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2020.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2022.

²¹Ku reflektohen edhe të dhënat për vitin ushtrimor paraardhës, pra, për vitin 1994.

ka zhvilluar aktivitet tregtar që prej vitit 1994 dhe ka realizuar një qarkullim total në vlerën 455.073.811 lekë dhe një fitim *neto* në vlerën 26.531.357, përgjatë periudhës 1994 – 2009²².

1.25. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit, duke qenë se rezultoi e provuar se: (i) pasuria e paluajtshme është përfituar me anë të trashëgimisë ligjore; (ii) nga aktet shkresore të administruara provohet se pronat e paluajtshme janë përfituar në vitin 1993; (iii) banesa 3-katëshe është ndërtuar në vitin 1995; (iv) rikonstruksioni i banesës ka ndodhur në vitet 2008-2009; (v) certifikata e pronësisë nr. ***, rezulton e lëshuar në datën 30.4.2008.

1.26. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016.

2. Pasuria arë, me sip. 2.723 m², në *-Krujë, në vlerën 300.000 lekë**

2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron pasurinë e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 2.723 m², që ndodhet në ***-Krujë, e fituar nëpërmjet kontratës për shitblerje tokë bujqësore nr. ***, datë 13.12.2001. Vlera: 300.000 lekë. Në kontratë nuk është përcaktuar pjesa takuese. Si burim krijimi, subjekti deklaron të ardhurat e biznesit familjar nga shoqëria “A. U.” sh.p.k. (ish-shoqëria “****”). Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²³.

2.2. Në seksionin “të dhënat konfidenciale”, subjekti ka deklaruar që nëpërmjet kontratës së shitblerjes tokë bujqësore nr. ***, datë 13.12.2001, është bërë bashkëpronare e kësaj pasurie të paluajtshme, por në momentin e lidhjes së kontratës, ka qenë në moshë të mitur (konkretisht 13 vjeçe) dhe, si rrjedhojë, kontrata është lidhur dhe nënshkruar nga mamaja e subjektit. Duke qenë se kjo kontratë nuk është regjistruar në ZVRPP-në Krujë, nuk ka pasur dijeni për ekzistencën e saj, deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe kjo është arsyeja përse këtë pasuri nuk e ka deklaruar në momentin e deklarimit fillestar e deri më sot. Sipas deklaratave të nënës së subjektit, pasuria “arë” është blerë nga të ardhurat prej biznesit familjar.

2.3. Nga hetimi i Komisionit, konstatohet se pasuria tokë bujqësore me sip. 2.723 m², me nr.***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, ndodhur në ***, Krujë, është blerë me kontratën nr. ***, datë 13.12.2001, me çmim 300.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Referuar kontratës në cilësinë e palës shitëse janë anëtarët e familjes bujqësore H., H., S., Q., B. dhe Z. U. dhe palë blerëse S., B. dhe A. U. (madhorë) dhe D. e Elsa Ulliri (të mitura) të pestë bashkëpronarë. Në cilësinë e palës blerëse kanë firmosur S., B. dhe A. U..

2.4. Origjina e pronës, referuar certifikatës së pronësisë me datë 6.12.2001 dhe kartelës së pasurisë, ka qenë e regjistruar në emër të H. U., bashkëlidhur certifikata e përbërjes familjare me anëtarë H., H., S., Q., B. dhe Z.U.

²²Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2010, duket të ketë pasaktësi, pasi vlera e fitimit rezultoi më e lartë se vlera e qarkullimit. Për rrjedhojë, të dhënat e këtij viti nuk u përfshinë në analizën e kryer.

²³Kontratë shitblerje tokë bujqësore nr. ***, datë 13.12.2001, certifikatë pronësisë në emër të H. U., me nr. pas. ***, e llojit arë sip. 2.723 m², në ***-Krujë, kartelë pasurie, harta treguese e regjistrimit, certifikatë e përbërjes familjare.

2.5. Komisioni, pasi analizoi përgjigjen e ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë²⁴, vëren se pasuria nr. *** ka ardhur nga bashkimi i ish-pasurive nr. *** (vol. ***, f. ***, e llojit are+truall me sip. 11.240, nga të cilat 300 m² truall e 120 m² ndërtesë) dhe nr. *** (vol. ***, f. *** e llojit arë me sip. 2723 m²).

2.6. Sa më sipër referohet, rezulton se ka mospërputhje në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit lidhur me pasurinë nr. ***. Kjo pasuri nuk duhet të ishte paraqitur/deklaruar si pasuri më vete nga ana e subjektit (pasi krijon *dublikim*), duke qenë se pasuria arë me sip. 2723 m² përfshihet (është shkrirë) në pasurinë nr. ***, të analizuar në pasurinë nr. 1 në vendim.

2.7. Subjekti, në përgjigje të prapësimeve, theksoi se nuk duhet ta kishte deklaruar këtë pronë si pasuri më vete pa e verifikuar paraprakisht pranë ish-ZVRPP-së Krujë. Shkaku i vetëm i deklarimit ka qenë me qëllim që të deklaronte për çdo pasuri që kishte dijeni dhe se për ekzistencën e kontratës së shitblerjes së kësaj toke bujqësore, kishte rënë në dijeni vetëm në ditët e fundit të dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

2.9. Pasaktësitë e konstatuara në deklarin *Vetting* nuk përbëjnë shkak për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, për aq sa këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk lidhen me mosdeklarimin apo fshehjen e ndonjë pasurie, por lidhen me parregullsi, të cilat janë shpjeguar nga subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

2.10. Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi ndonjë problematikë që lidhet me procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si mosdeklarimin, fshehjen apo deklarimin e rremë, por edhe në lidhje me kohën apo burimet e krijimit, duke qenë se nga aktet shkresore të administruara provohet se pasuria arë me sip. 2723 m² është përfituar në vitin 2001, me një nga format e parashikuara në ligj, shumë përpara se subjekti i rivlerësimit të merrte pozicionin e gjyqtarës në datën 21.10.2013.

2.11. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht pasaktësisë në deklarin, për shkak edhe të analizës më lart, nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjnë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Pasuria arë, me sip. 6700 m², në *-Krujë**

3.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 6700 m², në bashkëpronësi

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 10.5.2022.

me familjarët (S., B., A. dhe D. U.), përfitur në bazë të ligjit 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën“, trashëguar nga babai A. U.. Kjo pasuri nuk është përfitur nëpërmjet shitjes ose blerjes dhe, si rrjedhojë, nuk mund të vendoset një vlerë konkrete me shifra dhe fjalë. Në deklarinimin fillestar, subjekti shpjegon se ka deklaruar një shifër duke pasuar parasysh vlerën e tregut për këtë pronë dhe nuk është bërë vlerësimi i saj. Pjesa takuese: 20 %. Burimi i krijimit: përfitur me anë të trashëgimisë nga babai. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁵.

3.2. Nga hetimi i Komisionit, lidhur me origjinën e kësaj prone, rezulton se babai i ndjerë i subjektit A. U. me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi²⁶ nr. *** akti, dt. 10.5.1993, ka përfitur gjithsej pronën me sip. 17755 m² (sip. 6.900 m² nga të cilat 6.700 m² arë dhe 200 m² truall dhe arë me sip. 10.855 m²,) në fshatin ***-Krujë.

3.3. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2013, subjekti ka deklaruar tokë (arë) 6700 m², në vlerën 13.400.000 lekë, trashëguar nga babai. Pjesa takuese: 20 %. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, të ZVRPP-së Krujë, e cila konfirmon se pasuria nr. *** , vol. *** , f. *** , z. k. *** , e llojit arë, me sip. totale 6.700 m², në ***-Krujë, është pronë e përfitur në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, aktualisht në bashkëpronësi të shtetasve S., B., A., D. dhe Elsa Ulliri.

3.4. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, nga ZVRPP-ja Krujë²⁷, rezulton se në emër të subjektit dhe familjarëve të tij është e regjistruar pasuria nr.***, e llojit arë me sip. 6700 m² (sipas kartelës së pasurisë, para saktësimit ka qenë 6900 m² arë dhe 200 m² truall)²⁸. Gjithashtu, ZVRPP-ja Krujë, me anë të postës elektronike, datë 24.1.2019, konfirmon pasurinë arë me sip. totale 6.700 m², nr. *** , vol. *** , f.*** , origjina e pronës sipas AMTP-së nr. *** , në emër të shtetasit A. U.

3.5. Me anë të pyetësorit nr. 1²⁹, subjektit iu kërkuan shpjegime, lidhur me fitimin e pronësisë së sipërfaqes truall 200 m², pasi referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 24.1.2017, të ZVRPP-së Krujë, rezulton bashkëpronare në pasurinë me nr. *** , arë me sipërfaqe 6700 m², ndërkohë që referuar AMTP-së nr. *** , rezulton të jetë përfitur arë 6700 m² dhe truall 200 m². Në përgjigje³⁰, subjekti deklaroi se pasi u njoh me pyetësin ka ballafaquar dy dokumentet e sipërcituara dhe vëren se konstatimi është i drejtë. Këtë mospërputhje subjekti nuk e kishte konstatuar më parë, pasi gjithmonë e ka marrë të mirëqenë atë që rezulton e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe nga certifikata për vërtetim pronësie e lëshuar më 28.2.2002.³¹

²⁵Certifikatë pronësie, datë 28.2.2002, në emër të S. U., B. U., A. U., D. U. dhe Elsa Ulliri, lloji pasurisë arë me sip. 6700 m², kartela e pasurisë, harta treguese e regjistrimit, vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga ZVRPP-ja Krujë.

²⁶Në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2017, shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2017, shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2019.

²⁸Në kartelën e pasurisë është vendosur përshkrimi “sekuestro konservative nr. *** prot., datë 30.12.2014, ‘K. T.’ Person Privat”.

²⁹E-mail datë 29.4.2022, ora 13:06 dhe e-mail datë 4.5.2022, ora 11:33

³⁰E-mail datë 11.5.2022, ora 19:31

³¹Subjekti deklaroi se për sqarimin e këtyre rrethanave i është drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë me anë të një kërkesë për informacion. Sipas shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.5.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë, rezulton se pasuritë që janë përfitur sipas AMTP-së me nr. regj. *** , datë 8.5.1993. Këto pasuri kanë pësuar ndryshime në numër dhe sipërfaqe, si pasojë e azhurnimit të bërë nga grupi i matjeve në terren, në këtë rast në muajin dhjetor të vitit 1996 (LN ose printimi nr. ***). Këto ndryshime janë pasqyruar në kartelat e pasurive të paluajtshme, si edhe në hartat treguese

3.6. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë, Komisioni konstaton se sipërfaqja prej 200 m² e llojit truall, që sipas AMTP-së nr. *** ka qenë në sipërfaqen prej 6.900 m², pas azhornimit nuk ka rezultuar në këtë parcelë. Trualli (pra, sip. 200 m²) prej matjeve në terren (azhornimit) ka figuruar në parcelën nr. ***, me sip. 300 m² nga kjo 120 m² ndërtesë.

3.7. Lidhur me burimin e krijimit, rezulton se sipas vendimit nr. ***, datë 29.1.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për çelje trashëgimie ligjore, pas ndërrimit të jetës së shtetasit A. U., është përcaktuar se trashëgimtarë të radhës së parë janë bashkëshortja dhe 4 fëmijët e tij, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga 1/5 pjesë secili.

3.8. Pas analizimit të provave të administruara gjatë hetimit, Komisioni arrin në përfundimin se: (i) kjo pasuri është përfituar në vitin 1993; (ii) burimi i krijimit është i ligjshëm, si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë sipas Kodit Civil, me anë të trashëgimisë ligjore; (iii) regjistruar në regjistrat publik me certifikata e pronësisë e lëshuar në datën 28.2.2002.

3.9. Në konkluzion të analizimit të kësaj pasurie, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Llogari, në vlerën 157.325,28 lekë, në “Raiffeisen Bank”

4.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje në llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, deri në datën 13.12.2016. Vlera: 157.325,28 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Nuk deklarohet burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues³².

4.2. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “Raiffeisen Bank”³³ e ka konfirmuar llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga subjekti. Kjo llogari është çelur në nëntor të vitit 2011 dhe kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat.

4.3. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016.

5. Llogari, në vlerën 458,69 lekë, në “Credins Bank”

5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje në llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, deri në datën 27.1.2017. Vlera: 458,69 lekë. Pjesa takuese: 100%.

5.2. Nuk deklarohet burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues³⁴.

aktuale të cilat janë në shkallën 1:2500 (ndryshe nga hartat e përdorura për lëshimin e AMTP-ve në shk. 1:5000), shkallë në të cilën ASHK, Drejtoria Vendore Krujë punon ende edhe sot.

³²Vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017 i Raiffeisen Bank, nxjerrje llogarie dt. 24.1.2017, nga Raiffeisen Bank në emër të Elsa Ulliri, me gjendje në vlerën 157.325 lekë.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020

³⁴Nxjerrje llogarie, datë 27.1.2017, nga “Credins Bank”, në emër të Elsa Ulliri, llogari page në vlerën 458 lekë.

5.3. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “Credins Bank”³⁵ e ka konfirmuar llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga subjekti. Kjo llogari është çelur në nëntor të vitit 2013 dhe kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat.

5.4. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016.

6. Gjendje cash, në vlerën 100.000 lekë

6.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* të kursyera në shumën 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi, deklaroi të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë gjatë vitit 2016. Po ashtu, në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* të kursyera nga paga gjatë vitit 2016, në vlerën 100.000 lekë.

6.2. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për vitin 2016, nga ku u konstatua një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 158.465 lekë, për kursimin e gjendjes *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2016.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare e vitit 2016

Përshkrim	Vlerë
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	100,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	7,481
Total likuiditete	107,481
Të ardhura nga pagat subjekti	1,143,527
Të ardhura nga pagat motra D. U.	392,448
Total të ardhura	1,535,975
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së (4 persona)	940,368
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	646,591
Total shpenzime	1,586,959
Balanca e fondeve (të ardhura-shpenzime-likuiditete)	-158,465

6.3. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.4. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegon se aplikimi i vlerave të minimumit jetik të INSTAT-it nga Komisioni është bërë apriori pa marrë në konsideratë tregues të mënyrës së jetesës së familjes së tij. Sipas Raportit të Avokatit të Popullit “mbi llogaritjen e minimumit jetik” rezultoi se

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2020.

mungojnë aktet nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik dhe përshtatjen e kësaj mase në planin kohor. Përpjekjet e para për llogaritjen e minimumit jetik kanë filluar në vitin 2015, studime të cilat përcaktuan si minimum jetik vlerën 16.000 lekë/muaj, për frymë. Rrjedhimisht, duke marrë për bazë përbërjen familjare prej 4 personash kjo vlerë do të jetë 192.000 lekë/vit, ndërkohë që sipas tabelës, së cilës i referohet Komisioni, vlera e saj është 235.092 lekë/vit. Vlerat e përcaktuara në tabelat që përdoren nga Komisioni mbi llogaritjen e minimumit jetik nuk gjejnë mbështetje shkencore dhe as nuk bazohen në metodologjinë bashkëkohore që përdoret nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).

Më tej, subjekti deklaron se bashkë me familjen kanë jetuar gjatë gjithë kohës në fshatin ***-Krujë dhe, si rrjedhojë, standardi i jetesës nuk mund të jetë i njëjtë me atë të qytetit dhe aq më pak me atë të kryeqytetit dhe se një pjesë të nevojave ushqimore familja i plotëson me produkte të ndryshme bujqësore të prodhuara nga nëna e subjektit, duke bërë që shpenzimet e familjes të mos jenë në standardin e përcaktuar nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti shpjegon se nuk konsumojnë disa nga produktet bazë të shportës, të cilat zënë një zë të konsiderueshëm të shpenzimeve si: alkool, cigare etj. Në përfundim, subjekti deklaron se nëse shpenzimet jetike do të llogariten duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme, për vitin 2016 nuk do të rezultojë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kursimin e gjendjes *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.5. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratën në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.6. Pretendimi i subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike nuk mund të pranohet, pasi referuar edhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dysHEMEJA nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore³⁶. Shpenzimet e jetesës të përlllogaritura në analizën financiare të kryer nga Komisioni, bazohen në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019, përcjellë nga INSTAT-i, si i vetmi institucion përgjegjës dhe i specializuar në Republikën e Shqipërisë për treguesit statistikorë të konsumit vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë.

6.7. Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 158.465 lekë, për kursimin e gjendjes *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2016. Gjithsesi, kjo mungesë burimesh

³⁶Vendim nr. 08-2021 (JR), datë 9.3.2021, Kolegji i Posaçëm i Apelit.

në vitin 2016 nuk mund të merret në konsideratë për vlerësimin e ndonjë mase disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

7. Hua marrë nga nëna e subjektit S. U.

7.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka paraqitur: (i) vendim nr. ***, datë 4.10.2007, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me palë paditëse M. L. dhe e palë e paditur S. U., me objekt kthimin e shumës, që rrjedh nga kontrata e huadhënies nr. *** rep., datë 14.2.2005, përfshirë edhe interesat; (ii) urdhër ekzekutimi nr. ***, datë 29.2.2008, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me palë kërkuese M. L. me objekt “lëshim urdhër ekzekutimi i zyrës së përmbarimit Krujë; (iii) urdhrin nr. ***, datë 15.7.2014, të zyrës së përmbarimit Krujë “për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, me palë kreditore M. L. dhe palë debitore S. U.

7.2. Më tej, nga hetimi i Komisionit, konkretisht, nga dokumentacioni i përcjellë nga Noteri Publik Ç. H.³⁷, ndër të tjera, është administruar edhe deklarata noteriale nr. ***, datë 15.8.2016, lidhur me kthimin e kësaj huaje, palët M. e N. L. dhe S. U., deklarojnë se me marrëveshje midis tyre është likuiduar totalisht shuma e huas, kamat vonesat dhe interesat sipas kontratës së huas nr. *** regj., datë 14.2.2005. Palët kanë rënë dakord të fillojnë procedurën e kalimit të pasurive nga M. L., në emër të S. U. dhe nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me detyrimin.

7.3. Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konstatohet se: (i) në datën 14.2.2005, nëna e subjektit ka lidhur kontratë huaje me nr. *** regj., me shtetasin M. L. Referuar kësaj kontrate huadhënësi jep hua shumën prej 7.500.000 lekësh, deri në datën 14.2.2007, me një përqindje prej 1.5 %/muaj, të cilat do të jepeshin çdo datë 15 të çdo muaji; (ii) në datën 4.10.2007, huadhënësi M. L. ka ngritur padi ndaj nënës së subjektit S. U., me objekt detyrimin e të paditurës të kthejë shumën prej 7.500.000 lekësh, duke përfshirë interesat dhe kamat vonesat, duke qenë se kjo hua nuk ishte shlyer nga nënë e subjekti. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. ***, datë 4.10.2007, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur S. U. të paguajë shumën 14.545.913 lekë; (iii) në datën 29.8.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit nr. ***, datë 29.2.2008, për ekzekutimin në mënyrë të detyrueshme të vendimin nr. ***, datë 4.10.2007, detyrimin e palës së paditur S. U. të paguajë shumën 14.545.913 lekë; (iv) në datën 15.7.2014, Zyra Përmbarimore Krujë, me anë të urdhrin nr. ***, datë 15.7.2014, “Për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, ka urdhëruar ZVRPP-në Krujë të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetasit M. L., për pasuritë e paluajtshme të debitorit S. U., konkretisht: (i) 1/5 pjesë e pasurisë nr. *** tokë arrë me sip. 1.340 m²; dhe (ii) 1/5 pjesë në pasurinë nr. ***, shtëpi banimi 3 kate me sip. 36 m² dhe truall 60 m² + arë me sipërfaqe 1.872 m²; (v) në datën 15.8.2016, palët M. e N. L. dhe S. U., deklarojnë se me marrëveshje midis tyre është likuiduar totalisht shuma e huas, kamat vonesat dhe interesat, sipas kontratës së huas nr. *** regj., datë 14.2.2005. Palët kanë rënë dakord të fillojnë procedurën e kalimit të pasurive nga shtetasi M. L., në emër të S. U. dhe nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me detyrimin.

³⁷Shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.9.2022.

7.4. Sa më lart, me anë të pyetësorit nr. 1³⁸, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për shlyerjen e shumës 14.545.913 lekë, si dhe të deklarojë mënyrën e kryerjes së pagesës (*cash/bankë*) dhe datën/datat e shlyerjes.

7.5. Në përgjigje³⁹, subjekti deklaroi se në datën 15.8.2016, shtetasit M. L., N. L. dhe S. U. (në cilësinë e deklaruesve) kanë nënshkruar deklaratën noteriale me nr.***⁴⁰ dhe se vullnetet e shprehura në këtë deklaratë nuk janë përmbushur dhe nuk janë realizuar asnjëherë duke mbetur thjesht në letër⁴¹. Shtetasi M. L. vazhdon të jetë ende pronar i pasurisë nr. ***. Në deklaratën noteriale nuk është cituar as datë e shlyerjes së shumës dhe as mënyra e pagesës sepse realisht nuk është paguar asnjë shumë. Nëse do të ishte bërë ndonjë pagesë nga nëna e subjektit, atëherë midis tyre do të ishte lidhur kontrata e shitjes si e vetmja mënyrë e ligjshme për kalimin e pronësisë së një pasurie të paluajtshme dhe, si rrjedhojë, nuk do të lindte nevoja për nënshkrimin e një deklarate noteriale.

7.6. Në përfundim, subjekti deklaroi se bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2022, lëshuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Krujë, pasuria me nr. *** , vol. *** , f. *** , e llojit arë+truall, me sipërfaqe totale prej 1932.6 m² është në pronësi të shtetasit M. L., pajisur me certifikatë pronësie, datë 28.8.2014. Ky fakt provon që deklarata e mësipërme nuk është përmbushur dhe se nëna e tij nuk ka paguar asnjë para në favor të këtij shtetasi⁴². Këto fakte konfirmohen edhe nga shtetasi M. L., nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 9.5.2022.⁴³

7.7. Sipas deklaratës noteriale nr. *** , datë 9.5.2022, shtetasi M. L. ka deklaruar se në vitin 2016 po planifikonte hapjen e një biznesi për të cilin i duheshin shumë para dhe, si rrjedhim, po vlerësonte faktin e shitjes së pronës së fituar nga huamarrësja. Kjo e fundit nuk dëshironte që të ndryshonte dhe të veprohej sërish mbi pasurinë dhe me të marrë dijeni për këtë fakt i propozoi një marrëveshje, duke marrë përsipër se do të paguante shumën dhe ai t'i rikthente përsëri pasurinë në pronësi të saj. Në mënyrë që ky vullnet të dukej i vërtetë dhe serioz ka kërkuar shprehjen e tij para një noteri publik dhe, si rrjedhim, u hartua deklarata noteriale nr. *** , datë 15.8.2016. Shtetasja S. U. nuk arriti ta përmbushte këtë vullnet dhe nuk pagoi asnjë

³⁸E-mail, datë 29.4.2022, ora 13:06 dhe e-mail, datë 4.5.2022, ora 11:33.

³⁹E-mail, datë 11.5.2022, ora 19:31.

⁴⁰Ku citohet: “Ne deklaruesit deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale e ligjore se në bazë të kontratës së huas me nr.***, datë 14.2.2005, kemi hyrë në një marrëdhënie huaje mes njëri-tjetrit, procedurë që, më pas, ka përfunduar në gjykatë, pasi nuk është bërë likuidimit në kohë dhe sipas vendimit nr.***, datë 4.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka filluar procedura e ekzekutimit të kontratës së huas me nr.***, datë 14.2.2005 dhe më pas urdhri i ekzekutimit ka kaluar në përbarim që sipas rregullave është bërë edhe kalimi i pronësisë së pasurive në emër të M. L. dhe konkretisht pasuritë me nr. *** , vol. *** , f. *** , z. k. *** dhe 1/5, pjesë e S. U. që ka si origjinë pas. *** , vol. *** , f. *** , z. k.***. Palët më deklarojnë se në marrëveshje mes tyre janë likuiduar totalisht, të gjithë shumën e huas dhe interesat e huas dhe kamatvonesat që kanë pasur mes njëri tjetrit dhe janë dakord që të bëhet kalimi i pasurive nga M. L. në emër të S. U.. Palët më deklarojnë se janë likuiduar totalisht mes tyre dhe se nuk kanë asnjë pretendim as sot dhe as në të ardhmen në lidhje me detyrimin sa më sipër dhe janë dakord që të fillojnë procedurën e kalimit të pronësisë nga emri i M. L. tek S. U. ”.

⁴¹Pronari i ri i pronës kishte shprehur dëshirën për të vepruar mbi pasurinë e përfutur në bazë të procedurës përbarimore, por duke qenë se kishin dëshirë të ruanin pasurinë e trashëguar nga babai të pacopëzuar, nëna kontaktoi me shtetasin M. L. duke i ofruar t'i paguante kundërvlefën e pronës dhe më pas prona të kthehej në gjendjen e mëparshme, pra, në pronësi të saj. Shtetasi M. L. çdo shfaqje vullneti, veprim dëshironte ta materializonte edhe me akt noterial, duke kërkuar të nënshkruanin deklaratën e mësipërme noteriale, në të cilën shprehen se është paguar shuma e mësipërme dhe se pasuria nr. *** do të kalonte përsëri në pronësi të huamarrëses S. U..

⁴²Në të kundërt nuk do të lejonin që ende sot pasuria të vazhdonte të ishte në pronësi të tij, aq më tepër që marrëdhëniet e tyre nuk kanë qenë të mira nisur edhe nga fakti që kjo çështje ka përfunduar në gjykatë. Pra, situata juridike mbeti e pandryshuar, S. U. nuk bëri asnjë pagesë, ndërsa shtetasi M. L. vazhdon të ketë në pronësi pasurinë me nr. *** , duke bërë që kjo deklaratë noteriale të mbetet thjesht dëshirë e shprehur në letër.

⁴³Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** , datë 9.5.2022, me deklarues shtetasin M. L., shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë, kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë me nr.***.

shumë kundrejt tij, si rrjedhim nuk u përmbush marrëveshja e rënë dakord. Ajo nuk pagoi vlerën e sendit dhe as shtetasi M. L. nuk bëri kalimin e sendit në pronësi të saj. Me fjalë të tjera, secili mbeti në gjendjen e mëparshme dhe kjo pronë edhe sot është në pronësinë të shtetasit M. L..

7.8. Komisioni, pasi analizoi përgjigjen nr. *** prot., datë 10.5.2022, lëshuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Krujë, vëren se pasuria nr. ***, figuron në pronësi të shtetasit M. M. L., pajisur me certifikatë pronësie në datën 28.8.2014.

7.9. Nga hetimi në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Tiranë⁴⁴ nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin M. L.⁴⁵.

7.10. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se rezultoi e provuar se shuma 14.545.913 lekë nuk është shlyer sipas deklaratës së datës 15.06.2016, midis palëve, për aq sa pasuria, e cila do të kalohej në emër të nënës së subjektit pas likuidimit të kësaj shume, u provua se ishte akoma e regjistruar në emër të shtetasit M. L.. Për këtë arsye, Komisioni arrin në përfundimin se nuk rezultojnë problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit, duke qenë se nga aktet shkresore të administruara provohet se pasuria nr. ***, figuron aktualisht në pronësi të shtetasit M. M. L., pajisur me certifikatë pronësie, datë 28.8.2014, si dhe nuk rezulton të jetë lidhur kontratë shitje, si e vetmja mënyrë e ligjshme për kalimin e pronësisë së një pasurie të paluajtshme, parashikuar në Kodin Civil.

8. Dhurimi i 20% të kuotave të shoqërisë “A. U.” sh.p.k.

8.1. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në DIPP-në para fillimit të detyrës e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri ka deklaruar se është ortakë në mobilierinë “A. U.” sh.p.k. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 30.9.2014, subjekti është pyetur përse nuk janë zgjidhur kufizimet e interesave private të parashikuara në dispozitat ligjore. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se pjesën zotëruese prej 20 % të kuotave, me kontratën nr. ***, datë 25.9.2014, ia ka dhuruar motrës së saj D. U. Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar se ka lidhur kontratën nr. ***, datë 25.9.2014, sipas së cilës ka dhuruar të gjitha kuotat që zotëronte në kapitalin themeltar të shoqërisë “A. U.” sh.p.k.

8.2. Në deklaratën *Vetting*, seksioni “të dhënat konfidenciale”, subjekti deklaron se ka qenë ortakë pranë shoqërisë “A. U.” sh.p.k., duke zotëruar 20% të kuotave. Shoqëria është regjistruar në datën 26.2.1993 (emërtuar fillimisht si shoqëria “****”), me administrator dhe ortak të vetëm babanë e subjektit A. U. Duke qenë se babai ka ndërruar jetë më 13.12.1995, me vendimin nr.***, datë 29.1.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë, duke njohur si trashëgimtarë të tij, shtetasit S., B., A., D. dhe Elsa Ulliri, në pjesë të barabarta, nga 1/5 secili. Si rrjedhojë, subjekti ka trashëguar 20% të kuotave. Në datën 25.9.2014 ka lidhur një kontratë dhurimi kuotash, ku është në cilësinë e dhuruesit. Me anë të kësaj kontrate ka dhuruar të gjitha kuotat që zotëronte në kapitalin e shoqërisë “A.U.” sh.p.k. dhe prej kësaj date nuk rezulton ortakë e kësaj shoqërie. Shoqëria nuk ka pasur të ardhura gjatë periudhës 2011–2016, në këto kushte nuk ka pasur asnjë të ardhur prej saj gjatë periudhës tetor 2013 – shtator 2014. Subjekti paraqiti kontratën e dhurimit të kuotave nr. ***, datë 25.9.2014, sipas së cilës ia ka dhuruar motrës D. U. 20 % të kuotave që zotëronte në këtë shoqëri, në vlerën 22.000 lekë.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 16.5.2022.

⁴⁵Referuar dokumentacionit të administruar me shkresat nr. *** prot., datë 20.5.2022 dhe nr. *** prot., datë 30.5.2022.

Sipas ekstraktit historik të shoqërinë “A. U.” sh.p.k., në datën 8.10.2014 është regjistruar çështja “depozitim i vendimit datë 25.9.2014”, ku është vendosur dhurimi i 20% të kuotave të E. U. në favor të D. U.

8.3. Komisioni konstaton se ka pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në para fillimit të detyrës e vitit 2013 dhe në DIPP-në e vitit 2013, pasi nuk është deklaruar pjesa takuese/vlera e kuotave që subjekti zotëron në shoqërinë “A. U.” sh.p.k., përfituar me trashëgimi nga babai.

8.4. Subjekti, në përgjigje të prapësimeve, shpjegoi se mosdeklarimi i këtyre kuotave në vitin 2013 ka ardhur si pasojë e një pasaktësie. Këto kuota kanë ekzistuar para fillimit të detyrës dhe se në DIPP-në e vitit 2014 ka pasqyruar ndryshimet e ndodhura mbi to. Si rrjedhojë, subjekti pretendoi se nuk gjendet para deklaratimit të pamjaftueshëm të pasurisë, pasi nuk ndodhemi në kushtet e një pasurie të vënë gjatë detyrës, aq më pak para ndonjë pasurie të vënë në mënyrë të paligjshme për të pasur si qëllim fshehjen e saj.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

8.5. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

8.6. Pasaktësitë në deklaratimet e pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore. Për sa kohë këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk lidhen me fshehjen e ndonjë pasurie dhe pjesa takuese e kuotave që subjekti zotëronte në shoqërinë “A. U.” sh.p.k., rezultoi e provuar që është përfituar me trashëgimi nga babai.

8.7. Mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjnë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

9. Shpenzimet e udhëtimit të paguara nga xhaxhai i subjektit (në vlerën 1.000 euro)

9.1. Në pyetësorin standard, subjekti deklaroi se nga marrja e detyrës, më konkretisht në datat 20 - 24.12.2013, xhaxhai S. U. ka financuar një udhëtim të subjektit, në Milano, Itali (biletën, qëndrimin, akomodimin dhe shpenzimet për aktivitetet ku kanë marrë pjesë), në vlerën përafërsisht prej 1.000 euro. Burimi i kësaj dhurate dhe financimi janë të ardhurat dhe fitimet që xhaxhai ka pasur si qiradhënë.

9.2. Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 dhurimin e kësaj shume, bazuar në germën “f”, të nenit 4, e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, sipas të cilit duhet të deklarohen dhuratat ose trajtimet preferenciale në vlerën mbi 10.000 lekë, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale.

9.3. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues, lidhur me të ardhurat e z. S. U., si dhe iu kërkuan shpjegime se përse nuk është deklaruar kjo dhuratë në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale” të deklaratës periodike vjetore të vitit 2013. Në përgjigje, subjekti deklaroi se të ardhurat që kanë shërbyer për pagimin e këtyre shpenzimeve janë të ardhurat që xhaxhai përfiton edhe nga dhënia me qira e pasurive të tij. Për të provuar këtë fakt, subjekti paraqiti nxjerrje llogarie, për periudhën 1.1.2013-31.12.2013, të llogarisë bankare të xhaxhait S. U., ku rezulton e pasqyruar balanca, si dhe shuma e kaluar në favor të tij për qiradhënien. Gjithashtu, subjekti paraqiti vërtetimin, datë 6.5.2022, ku pasqyrohet paga mujore që xhaxhai i subjektit ka marrë gjatë vitit 2013. Subjekti deklaroi se nga këto dokumente rezulton se xhaxhai ka pasur mundësi ekonomike për të përballuar shpenzimet e këtij udhëtimi për të. Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj dhurate në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale” të deklaratës periodike vjetore të vitit 2013, subjekti deklaroi se ka qenë një gabim njerëzor të cilin e ka harruar ta deklarojë (përfshirë faktin që ishte hera e parë që plotësonte një deklaratë periodike vjetore), por e ka riparuar që në shtator të vitit 2014, në ILDKPKI, për të cilën është mbajtur edhe procesverbali përkatës. Fakti që është korrigjuar në kohë e madje para fillimit të procesit të rivlerësimit *Vetting* duhet marrë si provë e plotë dhe e vërtetë për të provuar faktin e harresës së deklaramit të saj si gabim njerëzor⁴⁶.

9.4. Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.5.2022, të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, shtetasi S. U. deklaroi se ai dhe familja e tij, së bashku me mbesën Elsa Ulliri kanë udhëtuar në Itali nga data 20 - 24.12.2013 dhe të gjitha shpenzimet e udhëtimit si bileta, akomodimi, qëndrimi etj., janë paguar prej tij. Kjo ka qenë dhuratë që i ka bërë mbesës për shkak të raportit të mirë që kanë me njëri-tjetrin.

9.5. Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është deklaruar burimi i financimit të udhëtimit në vlerën përafërsisht prej 1.000 euro, në DIPP-në e vitit 2013 dhe as në deklaratën *Vetting*, si një mundësi për të saktësuar të gjitha deklaramet, ndër vite, nuk do të merret në konsideratë dhurimi i kësaj shumë nga ana e xhaxhait të subjektit, bazuar kjo edhe në germën “F”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, sipas të cilit duhet të deklarohen dhuratat ose trajtimet preferenciale në vlerën mbi 10.000 lekë, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale.

9.6. Subjekti, në përgjigje të prapësimeve, deklaroi se ka qenë një gabim njerëzor, të cilin ka harruar ta deklarojë, duke qenë se ishte hera e parë që plotësonte një deklaratë periodike vjetore, por e ka riparuar në shtator të vitit 2014, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI. Fakti që është korrigjuar në kohë, madje para fillimit të procesit të rivlerësimit *Vetting*, provon që ka qenë një harresë (gabim njerëzor) dhe se nuk ka pasur si qëllim mosdeklarimin. Subjekti, gjithashtu, kërkon që të mbahet në konsideratë fakti që ka filluar stazhin profesional në datën 23.10.2013 dhe vetëm pas dy muajsh ka udhëtuar me xhaxhain dhe familjen e tij. Çështjet që ka pasur për gjykim gjatë kësaj periudhe kanë qenë të pakta, të gjitha kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

⁴⁶Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti: deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.5.2022, me deklarues shtetasin S. U.; vërtetimin, datë 6.5.2022, nga ISSh-ja; nxjerrje llogarie, për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013, të llogarisë bankare të shtetasit S. U.; procesverbal “mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, datë 30.9.2014, të mbajtur nga inspektori pranë ILDKPKI-së.

9.7. Gjithashtu, subjekti theksoi se në këtë udhëtim ka qenë me familjen e xhaxhait, si e ftuar e tyre dhe se do të ishte alogjike në aspektin human dhe njerëzor që xhaxhai të paguante për udhëtimin e tre fëmijëve të tij, ndërsa subjekti të paguante veçmas shpenzimet e tij.

9.8. Në përfundim, subjekti kërkon që Komisioni të marrë në konsideratë dhurimin e shumës prej 1.000 euro, në vitin 2013 dhe të konsiderohen të ardhura të ligjshme, duke e pasqyruar këtë fakt në analizën financiare të vitit 2013.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

9.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

9.10. Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të marrë në konsideratë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga xhaxhai i saj, duke qenë se subjekti e ka riparuar mosdeklarimin e dhurimit të shumës prej 1.000 euro, në deklaratimet e dhëna në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur në shtator të vitit 2014.

9.11. Po kështu, referuar vërtetimit të të ardhurave nga paga të shtetasit S. U./xhaxhai i subjektit⁴⁷ rezulton se ka pasur mundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të subjektit, të deklaruara në shumën prej 1.000 euro.

9.12. Sa më lart, duke zbritur shpenzimet e udhëtimit gjatë intervalit kohor 20.12.2013 - 24.12.2013, balanca negative për periudhën 21.10.2013 - 31.12.2013, reduktohet nga 152.328 lekë në 12.118 lekë.

10. Aktiviteti tregtar i nënës si person fizik, me NIPT ***

10.1. Sipas dokumentacionit të përcjellë nga QKB-ja⁴⁸, rezulton se në emër të nënës së subjektit/S. U., ka qenë i regjistruar person fizik “S. U.”, me NIPT ***, fusha e veprimtarisë “ekspozitë produktesh mobilierie”, data e regjistrimit 28.1.2014, me adresë *** Qendër, rruga “****” ndërtesë private 1-katëshe. Në datën 5.3.2018 është bërë kërkesë për çregjistrimin e personit fizik.

10.2. Bashkia Krujë⁴⁹ informon se gjatë verifikimeve të bëra në terren subjekti “S. U.”, me NIPT ***, nuk e ushtron veprimtarinë tregtare që nga viti 2015. Ky subjekt ka detyrime tatimore në shumën 487.754 lekë, ndaj Bashkisë Krujë dhe nuk ka deklaratë parashikuese të qarkullimit vjetor për periudhën që ka ushtruar aktivitetet.

10.3. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës⁵⁰ bën me dije se subjekti “S. U.” figuron e regjistruar në sistemin c@ts, pranë DRT-së Durrës, me administrator S. U., objekti i aktivitetit agjenci publiciteti, çregjistruar në datën 15.3.2018. Deklaratat tatimore të tatimit të thjeshtuar

⁴⁷Në pyetësorin nr. 1, subjekti ka paraqitur vërtetim për pagat e përfituara nga shtetasi S. U., nga ku rezulton që për periudhën 1.1.2012 – 30.11.2013 ka përfituar paga *bruto* në vlerën totale 1.150.000 lekë

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 5.2.2020.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2017, në dosjen ILDKPKI-së.

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2020.

mbi fitimin për vitet 2014, 2015, 2016 dhe deklaratat e kontributeve shoqërore për periudhat 1403, 1406, 1409, 1412, janë në vlerën 0 (zero) lekë. Detyrimet në kohë reale janë në vlerën 0 (zero) lekë.

10.4. Sa më lart, Komisioni vëren se nëna e subjektit nuk ka realizuar të ardhura nga aktiviteti tregtar si person fizik me NIPT ***.

11. Lidhur me deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting* të vitit 2017

11.1. Referuar certifikatës familjare të dorëzuar në pyetësorin standard, konstatohet se subjekti ka bërë shkëputjen nga trangu familjar në datën 28.10.2016 dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* nuk ka depozituar deklarime veçmas mbi pasuritë, të ardhurat, detyrimet etj., për shtetasit S., B. dhe D. U., pjesëtarë të trungut familjar.

11.2. Komisioni vëren se ligji nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016⁵¹. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e datës 25.10.2016, vendosi pezullimin⁵² e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, si edhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias, në lidhje me pajtueshmërinë e këtij ligji me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tej, Gjykata Kushtetuese, me vendim nr. 2, datë 18.1.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës me objekt: *Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në nenin 4/3 të ligjit, procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Sipas nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

11.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se nëna, motra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kanë pasur detyrimin që të deklarorin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private, pasi kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare në momentin që ligji ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016.

11.4. Sa rezulton, me anë të pyetësorit nr. 1⁵³, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e përfituara përgjatë periudhës 2013 – 2016, si dhe të deklarojë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shtuara përgjatë po kësaj periudhe, nga ana e shtetasve S., B. dhe D. U.

11.5. Në përgjigje⁵⁴, subjekti deklaroi sa vijon: “*Fillimisht dua t’ju bëj me dije se në kohën e përgatitjes së deklaratave për efekt të *Vetting*-ut jam interesuar edhe pranë ILDKPKI-së, nëse*

⁵¹Fletore Zyrtare nr. ***, datë 30.9.2016.

⁵²Në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

⁵³E-mail, datë 29.4.2022, ora 13:06 dhe e-mail datë 4.5.2022, ora 11:33.

⁵⁴E-mail, datë 11.5.2022, ora 19:31.

duhet të dorëzoj apo jo deklaratat e pasurisë edhe për tri shtetasit e cituar nga ana juaj. Nga punonjësit e ILDKPKI-së më është bërë me dije se nuk është e nevojshme që tri shtetasit e cituar nga ana juaj të dorëzonin deklaratën e pasurisë për shkak se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk ishin në të njëjtën përbërje familjare me mua. Në lidhje me të ardhurat dua t'ju them se nëna ime, shtetasja S. U. ka qenë administratore e shoqërisë '***' sh.p.k., por nuk ka realizuar të ardhura përgjatë viteve 2013 – 2016, pasi shoqëria nuk ka pasur aktivitet. Gjithashtu, dua të shtoj se pavarësisht se nëna ime nuk ka realizuar të ardhura nga shoqëria tregtare, ajo ka përmbushur nevojat jetësore të saj dhe të familjes me produktet e ndryshme të kultivuara në tokën e administruar prej saj. Shtetasi B. U., vëllai im nuk ka pasur të ardhura të dokumentuara përgjatë këtyre viteve. Ndërsa, motra D. U. ka qenë e punësuar pranë shoqërisë '***' sh.p.k. dhe po ju paraqes të ardhurat e saj përgjatë periudhës 2013 – 2016. Në lidhje me pyetjen e dytë dua të theksoj se asnjëri prej këtyre shtetasve nuk ka shtuar ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme gjatë periudhës 2013 – 2016, me përjashtim të motrës D., e cila nëpërmjet kontratës së dhurimit të kuotave nr. ***, datë 25.9.2014, ka përfituar 20 % të kuotave në kapitalin themeltar në shoqërinë⁵⁵ '***' sh.p.k.”.

11.6. Ndërkohë, nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja Krujë⁵⁶, rezultoi se në emër të nënës së subjektit S. U. është e regjistruar pasuria me nr. ***, e llojit arë me sip 1368 m², vol ***, f. ***, z. k. ***, ndodhur në ***-Krujë, certifikuar në datën 7.7.2008. Kjo pasuri është blerë, me kontratë, nr. ***, datë 14.12.1999, në vlerën 2.178.000 lekë.

11.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me konstatimin se: në deklaratën *Vetting* nuk janë deklaruar pasuritë dhe burimi i krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private të nënës, motrës dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit, që bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe kanë pasur detyrimin të deklaronin, pasi kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare në momentin që ligji ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016.

11.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se konstatimi i Komisionit është i drejtë dhe se në kohën e përgatitjes së deklaratave për efekt të procesit të rivlerësimit *Vetting* është interesuar në ILDKPKI, nëse duhet të dorëzonte apo jo deklaratat e pasurisë për nënën, motrën dhe vëllain, ku i është bërë me dije se nuk është e nevojshme, për shkak se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk ishin në të njëjtën përbërje familjare me subjektin. Më tej, sqaron se nuk ka pasur qëllim të mos deklaroj për nënën, motrën dhe vëllain, për sa kohë pasuria që ata zotërojnë dhe e kanë në bashkëpronësi, është pothuajse e njëjta me atë që subjekti ka deklaruar, duke qenë se është kryesisht e trashëguar nga babai i subjektit dhe përfituar, sipas ligjit nr. 7501/1991. Në përfundim, subjekti deklaron se nga hetimi i Komisioni nuk ka rezultuar ndonjë problematikë në lidhje me personat e lidhur, të cilët nuk kanë shtuar asnjë pasuri gjatë viteve 2013-2016 dhe nuk mund të

⁵⁵Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti: kontratë dhurimi kuotash nr. ***, datë 25.9.2014; vërtetim lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; vërtetim për bazën e vlerësuar, vulosur elektronikisht, datë 10.5.2022, nga ISSHH-ja.

⁵⁶Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2022.

konsiderohet si mosdeklarim i qëllimshëm për të mbuluar përfitime të paligjshme, si dhe ky veprim të mos konsiderohet si penalizues.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

11.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.10. Nëna, motra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private.

Nga hetimi administrativ kryesisht rezultoi se personat e lidhur nuk kanë shtuar pasuri gjatë viteve 2013 – 2016 dhe duken bindëse shpjegimet e subjektit se nuk mund të konsiderohet si mosdeklarim i qëllimshëm për të mbuluar përfitime të paligjshme, megjithatë Komisioni çmon se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*.

11.11. Nëse analizojmë deklarin e pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimit në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarin dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen nëse kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose nëse nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur, si dhe duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Por, duke qenë se shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i përcjellë krijojnë mundësi për të verifikuar që deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike, lidhur me krijimin e pasurive që personat e lidhur zotërojnë në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, provohet burimi i krijimit të këtyre pasurive, si dhe për shkak se nuk ka kontradikta mes deklaratës *Vetting*, deklarimeve periodike vjetore, deklarimeve përgjatë procesit të rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se ky deklarim jo i saktë për mos kuptimin e ligjit dhe formularit të deklaratës *Vetting*, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për aq sa Komisioni hetoi personat e lidhur dhe nuk konstatoi problematika që lidhen e procesin e rivlerësimit për subjektin.

12. Analiza financiare

12.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit, nënën, motrën dhe vëllain, për periudhën 21.10.2013 – 31.12.2016, nga ku rezultoi se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 152.328 lekë, për kryerjen e shpenzimeve përgjatë periudhës 21.10.2013 – 31.12.2013; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 158.465 lekë, për krijimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë vitit 2016, si dhe i vendosi në dispozicion subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1, me emërtim “analiza financiare” dhe aneksin nr. 2, me emërtim “metodika e analizës financiare”.

12.2. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12.3. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se niveli i jetesës së familjes nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë sipas vlerave të përcaktuara nga INSTAT, duke pasur parasysh vendbanimin, si dhe faktin që shumica e produkteve bujqësore prodhohen në shtëpi nga nëna. Më tej, kërkoi të mbahen në konsideratë shpenzimet e mbuluara nga xhaxhai për udhëtimin e kryer në vitin 2013, në Milano.

Pavarësisht kësaj, vijoi subjekti, është tashmë praktikë e konsoliduar e organeve të rivlerësimit që bilanci negativ deri në 1.000.000 lekë, bazuar në parimin e proporcionalitetit nuk vlerësohen si penalizues për të aplikuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektet e rivlerësimit. Në përfundim, subjekti kërkoi që bazuar në parimin e proporcionalitetit diferenca e rezultuar të mos konsiderohet si penalizuese nga Komisioni, për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

12.4. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

12.5. Referuar arsyetimit në paragrafët përkatës të këtij vendimi, Komisioni vendosi të marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimin në shumën 1.000 euro, në vitin 2013, të mbuluara nga xhaxhai i subjektit dhe, për pasojë, balanca negative, për periudhën 21.10.2013 - 31.12.2013, rezulton në shumën 12.118 lekë. Ndërkohë që pretendimet e subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike nuk qëndrojnë, pasi referuar edhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shpenzimet bazike përlllogariten sipas INSTAT-it, si i vetmi institucion përgjegjës dhe i specializuar në Republikën e Shqipërisë, për treguesit statistikorë të konsumit vjetor dhe mujor, për familje dhe për frymë.

12.6. Në përfundim, analiza financiare e rishikuar, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, për periudhën 21.10.2013 – 31.12.2016, paraqitet në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare, për periudhën 21.10.2013 – 31.12.2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
21.10.2013- 31.12.2013	0	0	-131	95,869	0	108,118	-12,118	-12,118
2014	0	0	-42,858	1,152,488	0	915,020	280,326	0
2015	0	0	201,325	1,383,972	0	1,020,989	161,658	0
2016	0	100,000	7,481	1,535,975	0	1,586,959	-158,465	-158,465

TOTAL	-	100,000	165,817	4,168,304	-	3,631,086	271,401	- 170,583
-------	---	---------	---------	-----------	---	-----------	---------	-----------

12.7. Sa më sipër analizohet, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 12.118 lekë, për kryerjen e shpenzimeve përgjatë periudhës 21.10.2013 – 31.12.2013 dhe mungesë burimesh të ligjshme në shumën 158.465 lekë, për krijimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë vitit 2016. Për pasojë, balanca negative përfundimtare rezulton në vlerën 170.583 lekë. Komisioni vlerëson se mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjnë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

13. Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

13.1 Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

13.2 Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e pamjaftueshmërisë në shumën 170.583 lekë, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

13.3 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

14. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 16.1.2020, të KDZH-së, duke konkluduar *në përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Elsa Ulliri.*

15. Në vazhdim, në Komision përcillet raporti vijues për kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 23.5.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 24.5.2022, të KDZH-së. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës në të cilën ushtronte detyrën si gjyqtare, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive Në përfundim, Grupi i Punës nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ndryshoi konstatimin fillestar të dhënë për

subjektin e rivlerësimit, nga *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri*.

16. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, në bazë të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në bashkëpunim dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar ka kryer disa aksese në dokumentacionin e klasifikuar të zotëruar nga institucionet verifikuese, për t'i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve të raportit të sipërpërmendur.

17. Komisioni, pasi analizoi *indiciet* e marra nga organet verifikuese dhe në vlerësim të fakteve të paraqitura, i kërkoi subjektit shpjegime, por që nuk lidheshin me vlerësimin e kontrollit të figurës sipas ligjit 84/2016.

18. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, në lidhje me konstatimin e DSIK-së *për papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës*.

19. Subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se ndihej e fyer dhe e zhgënjyer nga ky raport i DSIK-së. Subjekti shpjegoi se nuk ka shumë vjet në sistemin e drejtësisë, por gjatë këtyre viteve është përpjekur dhe mendon se ka arritur të japë drejtësi dhe të udhëhiqet gjithmonë nga ky parim. Një fakt i tillë sipas saj, rezulton qartësisht edhe nëse i referohemi denoncimeve të bëra ndaj saj, të cilat janë të pakta në numër, referuar çështjeve që ka pasur për gjykim gjatë viteve 2013 – 2021 (mbi 5000 çështje), zonës ku ka ushtruar detyrën etj. Subjekti deklaroi se raporti i dytë është hartuar në datën 23.5.2022, në kushtet kur objekt kontrolli për pastërtinë e figurës është periudha nga 1.1.2012 deri në datën e dorëzimit të deklaratës së figurës dhe se çdo informacion i ardhur jashtë periudhës së kontrollit të figurës dhe që nuk është informacion i mbledhur sipas një vendimi gjyqësor penal, nuk duhet të merret në konsideratë. Subjekti theksoi se gjatë gjithë ushtrimit të detyrës është përkushtuar të kryej me ndershmëri dhe vendosmëri detyrën e gjyqtarit, ka dhënë drejtësi duke respektuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve, ashtu siç ka dhënë ndëshkimet e merituar në rast shkelje të ligjit nga ana e tyre. Nuk i është nënshtruar kurrë presioneve dhe nuk ka çeduar kurrë nga përgjegjësia e marrë përsipër pavarësisht peshës së rastit. Në këto kushte, subjekti kërkoi që Komisioni të mos e marrë në konsideratë këtë raport të DSIK-së, pasi nga përmbajtja e tij nuk mund të konsiderohet i plotë dhe nuk mbështetet në të dhëna të sakta dhe objektive dhe, në përfundim, ta vlerësojë atë të përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

20. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ në lidhje me raportin e organeve verifikuese, prej të cilit rezultoi se të dhënat e paraqitura nuk përputhen me situatën faktike të çështjeve të shqyrtuara dhe nuk rezultuan veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, apo provojnë ndonjë kontakt të papërshtatshëm, sipas ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e figurës. Çështjet e hetuara nga Komisioni nuk parashikohen nga ligji i rivlerësimit, si shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës lidhur me këtë kriter, si dhe nuk rezultuan të dhëna që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar,

sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

21. Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

22. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

23. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional.

24. Ky vlerësim është bazuar: në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit; në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; në pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

25. Subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri ka marrë titullin “jurist”, nga universiteti “***”, Tiranë, në datën 25.6.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014. Me dekretin nr. ***, datë 21.10.2013, të Presidentit të Republikës, është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 25.9.2015, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku vazhdon aktualisht.

26. Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Nga dosjet e analizuara, rezultoi se në të tri raste janë ankimuar vendimet e dhëna nga subjekti, por janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor, vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

27. Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit Elsa Ulliri, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në dy gjykata të ndryshme. Kështu, në periudhën tetor 2013 – shtator 2014, ka kryer detyrën e gjyqtares provizore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (periudhë stazhi). Prej datës 25.9.2015 – 8.10.2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, tetor 2013 – shtator 2014, subjekti ka përfunduar së gjykuari 130 çështje, nga të cilat 31 çështje civile themeli + 10 çështje civile familjare, 84 kërkesa civile, 8 çështje penale themeli, (krime e kundërvajtje) dhe 7 kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, 25.9.2015 – 8.10.2016, subjekti ka përfunduar së gjykuari 751 çështje, nga të cilat 170 çështje civile themeli e civile familjare, 182 kërkesa civile, 89 çështje penale themeli, 187 kërkesa penale dhe 124 kërkesa penale masa sigurimi, duke plotësuar kështu standardin sasior sa i takon kësaj periudhe vlerësimi. Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, përgjithësisht, është efeciente dhe efektive në çështjet që ka shqyrtuar.

28. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – Rezulton se dosjet e analizuara janë vënë në lëvizje pa vonesa përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Seancat e vëzhguara, përgjithësisht, janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi, aktet në dosjet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk rezulton të jetë regjistruar asnjë ankesë për shkelje etike në punë të subjektit të rivlerësimit.

Integriteti Nuk janë konstatuar të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga dosjet e analizuara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e subjektit nga gjykimi, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

29. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga dosjet e vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor dhe në *CD-të audio* që pasqyrojnë seancat e regjistruara, është konstatuar se subjekti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 17 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

30. Të dhëna nga burime arkivore TË KLGJ-së

Nga analiza e të dhënave nga *data baza* e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në vitin 2016, në Inspektoratin e ish-KLD-së. Një ankesë e vitit 2016 është arkivuar, me arsyetimin se pretendimet për ligjshmëri vendimi zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa, një ankesë e vitit 2016 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është vendosur mbajtja në verifikim në vijim deri në përfundim të gjykimit, përcjellë me anë të procesverbalit *** prot., datë 28.7.2020, për trajtim ILD-së. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Hetimi i Komisionit

31. Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga viti 2016 dhe deri më sot⁵⁷.

31.1. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2022, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Elsa Ulliri janë depozituar 2 ankesa: ankesa e shtetasit F. Sh. e vitit 2016 dhe ankesa e shtetasit B. L. e vitit 2017. Për këto ankesa është vendosur arkivimi i tyre. Pasi u analizuan vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

31.2. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vëren se ndaj subjektit Elsa Ulliri janë depozituar 12 ankesa⁵⁸, për të cilat është vendosur arkivimi i tyre. Pasi u analizuan vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit⁵⁹. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore ndaj subjektit.

⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2022.

⁵⁸Në vitin 2017 - ankesa e shtetasit N. P.; në vitin 2018 - ankesa e shtetasës D. G., ankesa e shtetasit Z. Ll., ankesa e shtetasit A. Sh., ankesa e shtetasit B. L., ankesa e shtetasit B. A.; në vitin 2019 - ankesa e shtetasit G. K., 2 ankesa të shtetasit M. G., ankesa e shtetasit V. F.; në vitin 2021 - ankesa e shtetasit G. K., ankesa e shtetasës L. Z.

⁵⁹Më tej, KLGj-ja na bën me dije se ankesat: nr. *** prot., datë 13.4.2016, e ankuesit A. Sh.; nr. *** prot., datë 13.11.2018, e ankuesit V. M.; nr. *** prot., datë 6.6.2019, e ankuesit G. K., të cilat janë dorëzuar me procesverbalet nr. *** prot., datë 16.6.2020 dhe atë nr. *** prot., datë 28.7.2020, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

31.3. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2022, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Elsa Ulliri janë depozituar 9 ankesa⁶⁰, të cilat ndodhen në fazën e shqyrtimit. Pasi u analizuan vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

32. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan këto problematika dhe u kërkuan shpjegime e prova për sa vijon:

32.1. Çështja civile nr. ***, datë 3.2.2016⁶¹ - Nga hetimi konstatohet se dosja dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datë 23.5.2016, pas 19 ditëve nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se gjatë vitit 2016 ka dhënë 850 vendime, si rrjedhojë, brenda një periudhe të shkurtër kohore ka pasur për të arsyetuar shumë vendime dhe brenda javës ka shpallur mbi 30-40 vendime. Vendimi i konstatuar nga Komisioni ka marrë formë të prerë në datën 7.7.2016, pa u ankimuar dhe, si rrjedhojë, nuk ka ardhur ndonjë pasojë nga mosarsyetimi i tij brenda afatit 10-ditor.

32.2. Arsyetimi ligjor i Komisionit - Pasi u analizuan shpjegimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi bindshëm sa konstatohet, pasi tejkalimi i afatit 10-ditor të shpalljes së vendimit, nuk ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të mirë të punës nga ana e subjektit. Trupi gjykues vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

32.3. Çështja civile nr. ***, datë 7.2.2014⁶² - Nga hetimi konstatohet se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 8.5.2014, pas 13 ditëve nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se Komisioni duhet të mbajë në konsideratë se edhe sekretarja gjyqësore ka afatin e nevojshëm për të përgatitur dosjen dhe për ta dorëzuar në kryesekretari, afat 3-5 ditë.

32.4. Arsyetimi ligjor i Komisionit - Vonesa me tejkalim prej 3 ditësh është e papërfillshme në këtë rast krahasuar me ngarkesën e subjektit dhe, për pasojë, Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

33. Në sajë të informacioneve të marra nga organet verifikuese, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.3.2022, Komisioni, kërkoi administrimin e dosjeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 9.8.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

33.1. Çështja gjyqësore me palë shtetasin V. Gj., përfunduar me vendimin nr. ***, datë 4.11.2021 - Në vlerësim të fakteve të paraqitura, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti

⁶⁰Ankesa e shtetasit F. L.; ankesa e shtetasit J. F.; 2 ankesa të shtetasit G. K.; ankesa e shtetasit V. F.; 2 ankesa të shtetasit A. Sh. Për këto ankesa është vendosur arkivimi i tyre pas shqyrtimit fillestar. Ankesa e shtetasit D. K.; ankesa e shtetasit Gj. Sh.

⁶¹Palë paditëse shoqëria "****" sh.a., kundër të paditurit ***, Lezhë, me objekt "detyrimin e të paditurit të paguajë shumën e papaguar nga shërbimi telefonik fiks".

⁶²Palë paditëse K. B., kundër të paditurit shoqëria "****" sh.a., me objekt "zgjidhja e marrëdhënieve të punës".

lidhur me konstatimin se duke caktuar një mase më të lehtë sigurimi “detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, duket se subjekti i rivlerësimit e ka favorizuar personit nën hetim V. Gj., ndërkohë që ky shtetas për të njëjtën veprë penale, rezulton i dënuar më parë dhe është vendosur në provë nga gjykata për një periudhë të caktuar kohore.

33.2. Në shpjegimet e tij, subjekti deklaroi se nuk e ka favorizuar personin nën hetim dhe se rrethana e vetme rënduese në rastin konkret për ka qenë fakti që ky shtetas ka qenë i dënuar edhe më parë, por duhet të ishin mbajtur në konsideratë edhe rrethanat e tjera të cituara në vendim si: arsimi, profesioni (për të mos e penguar që të vazhdojë punën e tij si mësues), gjendja familjare (babai në moshë të thyer e për të cilin kujdeset), dënimi që parashikohet për këtë veprë penale, qëndrimi i personit, etj. Prokurori në rastin konkret nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimet e palës së dyshuar, por e ka bazuar kërkimin e tij vetëm te fakti që personi është i dënuar, pa paraqitur asnjë arsye apo provë se përse masat e tjera të sigurimit nuk janë të përshtatshme. Pra, rezulton se edhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vlerësuar se duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e mësipërme, ndaj shtetasit nuk mund të caktohet masa e kërkuar nga prokurori. Tjetër fakt që duhet të mbahet në konsideratë është se nuk ekziston potencialisht rreziku për përsëritje të veprës penale, për shkak edhe të heqjes së lejes së drejtimit administrativisht nga policia, sipas Kodit Rrugor.

33.3. Subjekti deklaroi se vendimi i dhënë prej tij është i mbështetur plotësisht edhe në vendimin unifikues nr. 7/2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁶³. Në caktimin e kësaj mase, përveç nivelit relativisht të ulët të marzheve të dënimit (potencial), gjykata mban në konsideratë faktin se nga kryerja e kësaj vepre nuk ka ardhur asnjë pasojë (qoftë dhe e lehtë) dhe se i dyshuari, pavarësisht se i dënuar më parë, nuk paraqet rrezikshmëri për komunitetin ku banon dhe nuk paraqet nevoja të veçanta sigurimi, si dhe duhet të mbahet në konsideratë edhe fakti se personi nuk e ka kryer veprën penale gjatë kohës që ka qenë në periudhë prove, pra, periudha e provës e dhënë nga gjykata nëpërmjet vendimit të dënimit është përmbushur dhe vuajtja e dënimit ka qenë ekzekutuar nga ana e personit nën hetim.

33.4. Arsyetimi ligjor i Komisionit - Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me dhënien e masës së sigurisë “*detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*”, ndaj shtetasit V. Gj. Trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i vendimit nga Gjykata e Apelit nuk mund të përbëj shkak për vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ndodhemi para parashikimit të pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.*”

33.5. Referuar në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁶⁴, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues, rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt

⁶³ “[...] ... nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2, të nenit 229, të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të të pandehurit, nëse ka precedentë penalë, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij... ”.

⁶⁴Vendimin nr. ***, datë 13.7.2020.

me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra, me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohet e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi.

Denoncime nga publiku

34. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Elsa Ulliri, janë administruar 16 denoncime nga publiku. Në 13 prej këtyre denoncimeve, në të cilat ngrihen pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për dhënien e vendimeve të padrejta, Komisioni vlerësoi se nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 26.1.2018, i shtetasit V. P.; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 2.2.2018, i shtetasit D. P.; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 5.4.2018, i shtetasit F. S.; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 24.7.2018, i shtetasit Gj. N.; (5) denoncimi nr. *** prot., datë 24.7.2019, i shtetasit N. K.; (6) denoncimet nr. *** prot., datë 21.10.2019, nr. *** prot., datë 6.11.2019, dhe nr. *** prot., datë 1.3.2021, të shtetasit M. Gj.; (7) denoncimi nr. *** prot., datë 21.9.2020, i shtetasit Gj. F.; (8) denoncimi nr. *** prot., datë 4.3.2021, anonim; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 6.4.2021, anonim; (10) denoncimi nr. *** prot., datë 6.14.2021, anonim; (11) denoncimi nr. *** prot., datë 36.12.2021, anonim.

35. Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

36. Në tri nga denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa vijon:

36.1. Denoncimi nr. *** prot., datë 26.9.2018, i shtetasit A. Sh., i cili ankohet për dhënien e vendimeve të padrejta nga gjyqtarët D. D., I. P., J. N., E. B., T. S. dhe Elsa Ulliri, në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Lezhë gjatë gjyqimit të çështjes penale nr. ***, datë 31.7.2015, në ngarkim të shtetasve M. P., A. T., E. N., S. P. akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje, prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municione, moskallëzim krimi”.

36.2. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti lidhur me konstatimin se: Duket se gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar parashikimet e legjislacionit procedural penal dhe praktikës gjyqësore, lidhur me deklaratimet e palëve gjatë hetimeve paraprake, fuqisë së tyre provuese dhe mënyrës se si ato interpretohen dhe analizohen nga gjykatat, bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale.

36.3. Subjekti, në përgjigje të prapësimeve, deklaroi se: Në çmuarjen e provave dhe në vlerësimin e deklaratimeve të dhëna gjatë hetimeve paraprake, trupi gjykues në shkallë të parë, ka mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku në vendimin nr. ***, datë 10.6.2015, ndër të tjera, thuhet se: “...në rastin kur dëshmitari është i pranishëm në seancë gjyqësore dhe pranon t’i përgjigjet pyetjeve të organit të akuzës si dhe të mbrojtjes,

atëherë vetëm thëniet e tij në seancë gjyqësore, pra vetëm dëshmia e tij do të merret parasysh si provë dhe do të çmohet për efekt të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të akuzës. Thëniet kontradiktore (gjatë gjykimit dhe gjatë hetimeve paraprake) 'asgjësojnë njëra-tjetrën', duke goditur besueshmërinë e personit dhe bërë dëshminë e tij për efekt të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, si 'të pavërtetë', por jo domosdoshmërisht anasjelltas. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 11.02.2015. Në rastin kur dëshmitari është i pranishëm në seancë gjyqësore dhe pranon t'i përgjigjet pyetjeve të organit të akuzës, si dhe të mbrojtjes, atëherë vetëm thëniet e tij në seancë gjyqësore, pra, vetëm dëshmia e tij do të merret parasysh si provë dhe do të çmohet për efekt të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të akuzës⁶⁵". Gjykata e Apelit Shkodër në rastin konkret duket se ka pasur një qasje të ndryshme nga ajo e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mbi mënyrën e interpretimit të rregullave të çmuarjes së provave. Për këto arsye, gjykata bëri një vlerësim të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë dhe çmoi të ndryshojë pjesërisht vendimin e shkallës së parë për një prej disponimeve dhe të lë në fuqi pjesën tjetër.

36.4. Arsyetimi ligjor - Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi bindshëm sa konstatohet dhe se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, pasi ndodhemi para parashikimit pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet." Referuar praktikës së Kolegjit, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra, me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi.

36.5. Denoncimet nr. *** prot., datë 10.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 3.6.2022, anonim, ku subjekti Elsa Ulliri akuzohet për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit F. N., i akuzuar ndërtim i paligjshëm. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti lidhur me konstatimin se: Nga ana e kërkuesit F. N. nuk është paraqitur asnjë provë apo rrethanë e re për të vërtetuar se nevojat e sigurimit ndaj tij janë zbutur, sikundër parashikon neni 260, paragrafi II, i Kodit të Procedurës Penale.

36.6. Në përgjigje të prapësimeve, subjekti deklaroi se organi i akuzës në lidhje me shtetasit që dyshohen se kanë kryer veprimet konkrete të paligjshme për miratimin e lejes së ndërtimit ka kërkuar masa më të lehta, të cilët janë pikërisht ata që kanë kryer veprimet konkrete dhe të drejtpërdrejta në lidhje me pasojën e ardhur, pra, ndërtimin e paligjshëm. Si rrjedhojë, vetë prokurori duhet të kishte paraqitur kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj

⁶⁵Në pikën 3, të nenit 362, të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se: "Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre", si dhe vendimin nr. ***, datë 11.2.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku, ndër të tjera, thuhet se: "Në çdo rast, për dëshmitë e të bashkëpandehurve, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar -- duke pasur parasysh edhe konfliktin potencial të interesave në fjalë - marrjen me rezervë nga ana e gjykatës (edhe kur nuk kundërshtohen nga palët), duke sanksionuar vlerësimin e tyre në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre". Në pikën 3, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet shprehimisht se: "Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre."..

shtetasit F. N. Shkaku kryesor i zëvendësimit të masës së sigurimit nuk kanë qenë arsytet shëndetësore, por qëndrimi që ka mbajtur prokurori për personat e tjerë nën hetim. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Shkodër e ka lënë në fuqi vendimin e dhënë në shkallë të parë dhe ky vendim ka marrë formë të prerë.

36.7. Arsyetimi ligjor i Komisionit - Sikundër është konstatuar gjatë hetimit të Komisionit, rezulton se subjekti në vendim ka arsyetuar se masa e sigurimit duhet të ndryshohet dhe zëvendësohet për shkak se duhet të mbahet parasysh qëndrimi i mbajtur nga prokurori në lidhje me personat e tjerë nën hetim. Konstatohet se organi i akuzës, në lidhje me shtetasit që dyshohen se kanë kryer veprimet konkrete të paligjshme për miratimin e lejes së ndërtimit, ka kërkuar masa më të lehta⁶⁶. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2021, e ka lënë në fuqi vendimin e subjektit duke arsyetuar, pikërisht, se fakti që ndaj të dyshuarve të tjerë është pranuar një masë siguri më e lehtë, konsiderohet me të drejtë se përbën shkak për pranimin e kërkesës së të dyshuarit F. N. për zëvendësimin e masës së sigurimit.

36.8. Sa rezulton, Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi bindshëm sa konstatohet dhe se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, pasi ndodhemi para parashikimit të pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet*”. Përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra, me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi.

37. Sa më sipër, pas analizimit të denoncimeve të paraqitura, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se denoncimet e trajtuara nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

38. Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçiente në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Elsa Ulliri, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

⁶⁶Prokuroria në datën 23.11.2020, ka kërkuar të caktohet ndaj shtetasit S. T., masa e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe ndaj shtetasve N. C. dhe A. M., masa ndaluese “pezullimi i ushtrimit të një detyrë apo shërbimi publik”.

- a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elsa Ulliri, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Lezhë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 30.6.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj